



KËRKESË PËR PROPOZIM PËR MALLRA Veturë Elektrike Hibride Plug-In

Numri i prokurimit:	FKGK 005/2025
Data e publikimit:	02/04/2025
Afati për dorëzimin e pyetjeve:	09/04/2025 në ora 15:00
Data e mbylljes:	16/04/2025 në ora 15:00
Objekt i kontratës:	Blerje për Veturë Elektrike Hibride Plug-In (PHEV)
Autoriteti kontraktues:	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK)
Lloji i njoftimit:	Kërkesë për Propozime për Mallra
Adresa:	Rr. Njazi Alishani nr. 4, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Email:	procurement@fondikgk.org
Telefoni:	+383(0)38 225 600

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është entitet juridik i pavarur i krijuar sipas Ligjit Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.08/L-138.

FKGK është krijuar për të ndihmuar në përmbushjen e nevojës për rritje të qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjen e prodhimit vendor dhe shërbimet me vlerë të shtuar, përmirësimin të bilancit tregtar dhe për të zgjeruar mundësitë e financimit për NMVM- të.

Të gjitha pyetjet lidhur me përmbajtjen e kësaj Kërkesë për Propozime duhet të dorëzohen në e-mail adresën dhe afatin e shënuar më lartë. Pas përfundimit të afatit për pranimin e pyetjeve, një dokument që përmban të gjitha pyetjet e anonimizuar, së bashku me përgjigjet e FKGK-së do t'u dërgohet të gjithë propozuesve në e-mail adresat e tyre të specifikuar në e-mailin për kërkesën e KPP-së dhe që duhen shënuar në brendësi të pjesës teknike të propozimit të tyre. Pyetjet që bëhen përmes telefonit nuk do të pranohen dhe nuk do të marrin përgjigje.

Asnjë informatë në këtë Kërkesë për Propozime nuk përbën ofertë formale për lidhjen e kontratës për blerjen e mallrave dhe publikimi i kësaj Kërkesë për Propozime nuk e obligon FKGK-në që të procedojë me zgjedhjen e cilitdo propozues.

FKGK rezervon të drejtën për të refuzuar ndonjë ose të gjitha propozimet nëse ato konsiderohen si teknikisht ose financiarisht jo të përgjegjshme ndaj kësaj Kërkesë për Propozime.

FKGK nuk është dhe nuk do të jetë përgjegjëse për cilëndo kosto që lidhet me përgatitjen dhe dorëzimin e propozimeve, prezantimet e mundshme të drejtpërdrejta, procesin e negociatave ose aktivitete të tjera që lidhen me procesin e përzgjedhjes.

II. QËLLIMI I KËRKESËS PËR PROPOZIME

Qëllimi i kësaj Kërkese për Propozime është që të ftojë kompanitë profesionale të paraqesin ofertë për mallrat e kërkuara sipas kësaj KPPM-je. Tenderuesi i suksesshëm do të ftohet për të negociuar një kontratë për shitblerje me FKGK.

III. KRITERET E OBLIGUESHME

Propozuesit duhet të dëshmojnë qartë se i përmbush kriteret e obligueshme të përcaktuara më poshtë ose ato do të përjashtohen nga shqyrtimi i mëtejshëm gjatë procesit të vlerësimit:

- Kopjen e Çertifikatës së Regjistrimit të Biznesit dhe Informata mbi Biznesin
- Çertifikatën e TVSH-së dhe Vërtetimin Tatimor nga ATK.
- Kopjen e letërnjoftimit të pronar-it/ëve dhe person-it/ave të autorizuar.
- Nënshkrimin e Deklaratës nën betim (<https://fondikgk.org/mundesi-partneriteti/>)
- Ofertuesi duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi për shitjen dhe servisimin e automjetit për të cilin oferton si dhe duhet të posedojë pajisjet dhe logjistikën e nevojshme për servisim dhe mirëmbajtje të automjetit gjatë periudhës së garancionit apo kohëzgjatjes së kontratës. Ofertuesi duhet të ketë autorizimin nga prodhuesi për tregtimin e markës së ofruar.
- Ofertuesi duhet të ofrojë mbulim garancie të automjetit për jo më pak se (5) vjet.
- Ofertuesi duhet të paraqesë vlefshmërinë/garancionin e automjeteve me apo pa kufizim në kilometrat e kaluara në motor, marsh dhe elektrikë, garancionin në ngjyrën e automjetit, garancionin në bateri të automjetit si dhe garancionin në karoseri kundër korrozionit.
- Ofertuesit duhet të sigurojë instucionin se GPS pajisjet mund të montohen në automjetet elektrike që ofertojnë.
- Kompanitë ofertuese duhet të paraqesin saktë kohën e liferimit të automjeteve.
- Kompanitë ofertuese duhet të ofertojnë edhe për servisimin e rregullt të automjeteve deri në 100.000 km.

IV. MALLRAT E KËRKUARA

Karakteristikat minimale të kërkuara të automjetit Plug-in Hibrid Elektrik :

- Lloji i veturës: Veturë e vogël ose Hatchback.
- Garancioni për pjesët (jo hargjuese) duhet të jetë minimalisht 5 vjet.
- Kapaciteti minimal i baterisë: ≥ 10 kWh
- Autonomia në modalitetin elektrik (WLTP): ≥ 40 km sipas standardit WLTP¹.
- Për veturat hibride plug-in (PHEV), mbushja e baterisë duhet të mbështesë mbushjen AC me një prizë Type 2.
- Sensorët e parkimit dhe sinjalet paralajmëruese për pengesat në pjesën e përparme dhe të pasme "Park Distance Control".
- Frenim autonom emergjent "Front Assist" me monitorim të këmbësorëve dhe çiklistëve.
- Dy ulëset e përparme duhet të jetë me mundësinë e rregullimit për të gjitha opsionet (përfshirë lartësinë).

¹ WLTP - Worldwide Harmonized Light Vehicles Test Procedure

- Pasqyra të jashtme të pasme të rregullueshme dhe të palosshme elektrike.
- Vetura duhet të ketë një kamerë të pasme dhe sensorë 360 gradë.
- Ndihma e parë, trekëndësh paralajmërues dhe jelek sigurie.
- Sistemi i monitorimit të presionit të gomave.
- Vetura duhet të kenë 5 dyer dhe 5 ulëse.
- Vetura duhet të kenë një kapacitet minimal të bagazhit prej 150 - 300L.
- Ngjyra e veturës mund të variojë.
- Vetura duhet të ketë rrota të aluminit (rrota aliazhi).
- Kohëzgjatja e liferimit të veturave nga data e nënshkrimit të marrëveshjes duhet të jetë maksimalisht 120 ditë kalendarike.
- Ofrimi i mundësisë për testimin e veturave është i obligueshëm.
- Vetura duhet të jete hibride plug-in (PHEV), me motor me djegie të brendshme dhe motor elektrik.
- Fuqia totale e sistemit (motor me djegie + motor elektrik) duhet të jetë $\geq 100KW$.
- Vetura e pajisur me Airbag përpara dhe Airbag anësorë për shoferin dhe pasagjerët, ABS, ESP, EBA, EBD.

V. PËRMBAJTJA E PROPOZIMIT

Propozimi mund të dorëzohet në gjuhët shqip, serbisht, apo anglisht dhe përbëhet nga dy (2) pjesë, Pjesa Teknike dhe Pjesa Financiare. Pjesa Teknike dhe Pjesa Financiare duhet të nënshkruhen nga një përfaqësues i autorizuar i kompanisë dhe të vendosen në zarfe të veçanta në të cilat duhet të shënohet qartë nëse është Pjesa Teknike apo Pjesa Financiare.

Dy zarfet më pas vendosen në një paketim ose zarf më të madh në të cilin shënohen informatat në vijim:

Adresa për Dorëzim:	<i>Fondi Kosovar për Garanci Kreditore Rr. Njazi Alishani Nr.4 Prishtinë, Kosovë, 10000</i>
Titulli i Prokurimit:	Blerje për Veturë Elektrike Hibride Plug-in (PHEV)
Numri i Prokurimit:	<i>[FKGK 005/2025]</i>

Propozimi dorëzohet vetëm në kopje të shtypur në adresën e shënuar në faqen e parë të kësaj Kërkese për Propozime.

Propozimi duhet të dorëzohet në lokacionin e specifikuar para përfundimit të afatit të fundit.

VI. PJESA TEKNIKE

Qëllimi i propozimit teknik është që të demonstrohen dhe dëshmohen perfaqësitë dhe licencat që posedon kompania, të drejtën apo kompetencat dhe kapacitetin e kompanive që do të ofrojnë mallrat në përputhje me këtë Kërkese për Propozime për Mallra (KPPM).

VII. PJESA FINANCIARE

Propozimi i kostos duhet të jetë i kuotuar me TVSH (Tatimi mbi Vlerën e Shtuar).

Propozimi i kostos duhet të përfshijë të gjitha mallrat sipas kërkesave të specifikuara në këtë KPPM.

Metoda e vlerësimit

Propozimet e dorëzuara do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga një komision i përbërë nga përfaqësues të FKGK. Propozimet do të vlerësohen së pari për të siguruar që kompania ka licencimet e duhura apo të drejtën për të ofruar mallrat sipas kërkesës.

Dhënia e kontratës do të bazohet në parimin "*çmimi më i favorshëm*".

Shënim:

- **Ofertuesit që nuk përzgjidhen në fazën e parë kanë të drejtë ankese brenda 7 ditëve të punës nga marrja e njoftimit për rezultatet e fazës përkatëse të përzgjedhjes.**